



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË***  
***(Mbajtur, më 11.10.2018)***

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Mbi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë për shkak të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin e datës 10.10.2018 të znj. Entela Prifti, me detyrë gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës së Apelit Korçë.

***Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:18 dhe mbaroi në orën 19:21.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                |                         |
|--------------------------------|-------------------------|
| <b><i>1. Ilir Meta</i></b>     | <b><i>(kryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Gjin Gjoni</i></b>    | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>3. Vangjel Kosta</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>4. Brunilda Kadi</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>5. Eneida Civici</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>6. Petrit Çomo</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>7. Ridvan Hado</i></b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>  |

8. *Gerd Hoxha* (anëtar)

9. *Neritan Cena* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Xhezair Zaganjroi, znj. Etilda Gjonaj, z. Astrit Haxhialushi.*

*Shënim 2:* Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018 bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur për subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht anëtar i KLD-sw z. Artan Broci, shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit. Deri në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelit ky gjyqtar, pezullohet nga ushtrimi i detyrës, parashikuar kjo specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
5. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
6. *Ekspertë të Misionit EURALIUS.*
7. *Ekspertë të USAID-it.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Mbi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë për shkak të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin e datës 10.10.2018 të znj. Entela Prifti, me detyrë gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës së Apelit Korçë.

*Ilir Meta:* E kemi kuorumin apo jo?

Mirë! Atëherë mos t’ju marrim kohën, se ishte një mbledhje e papritur.

Fillojmë atëherë me këtë rend dite mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kemi komandimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë për shkak se kryetarja aktuale, bazuar në vendimin e fundit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konsiderohet e pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Keni bashkëlidhur relacionin.

Dhe pika e dytë, si gjithmonë është çështja e delegimeve.

Atëherë, për pikën e parë, zoti Pjerin, një sqarim të shpejtë të lutem.

**Pjerin Prendi:** Atëherë, shkurtimisht, sepse anëtarët e kanë besoj secili relacionin. Ditën e djeshme jemi njoftuar nëpërmjet mediave se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar nga detyra kryetaren e Gjykatës së Apelit Korçë, znj. Etleva Prifti. Ditën e sotme ne i kemi nisur edhe një shkresë kryetares së KPK-së dhe i kemi kërkuar të konfirmojë këtë vendimmarrje. Ka dërguar shkresë ku ka konfirmuar vendimmarrjen e tyre, shkarkimin nga detyra të zonjës Prifti. Kështu që, në këtë situatë, Këshilli besoj që duhet të zgjedhë/komandojë një person nga katër gjyqtarët e ngelur nga ajo gjykatë, pasi edhe Sotiraq Lubonja, që ka qenë anëtar, para tre ditësh është shkarkuar edhe ai nga kjo gjykatë. Duhet komanduar një person tjetër për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës, sidomos për shkak të masave të sigurimit që janë të ngutshme dhe kanë karakter të ngutshëm dhe nuk mund të pritët gjatë komandimi i njërit prej anëtarëve.

Në relacion janë të dhënat e katër gjyqtarëve të tjerë. Janë Brunilda Orhani me 23 vite punë, me vlerësime “Shumë mirë” (dy vlerësimet). Është Etleva Temo, 24 vjet, me dy vlerësime... Është Olsi Xhavella me 17 vjet dhe Stavri Kallço 30 vjet.

Kështu që në këto kushte duhet zgjedhur njëri prej këtyre për të drejtuar përkohësisht këtë detyrë.

**Illir Meta:** Faleminderit!

Kush ka...?

**Gjin Gjoni:** Dakord! Duke qenë se çështja është e ngutshme, normalisht janë edhe masat e sigurimit, të gjitha veprimet e tjera të kancelarisë dhe veprimet procedurale që janë në lidhje me fondin, unë mendoj që duke parë edhe listën e cila është paraqitur, duke qenë se ajo e para ka një periudhë kohore që nga viti 2003 që është në Gjykatën e Apelit, ndoshta mund ta... Brunilda Orhani, ndërsa këto të tjerët janë në periudha kohore shumë më të vona në lidhje me emërimin e tyre në gjykatën e apelit.

*Neritan Cena:* Komandimi të jetë deri në zgjidhjen me vendim të formës së prerë të çështjes së zonjës Prifti dhe pastaj të shqyrtojmë edhe pjesën e komandimit. Po pra, ta kemi të kushtëzuar deri sa të marrë formë të prerë.

*(Mikrofonat në sallë kanë qenë të mbyllur gjatë votimit.)*

*(Miratohet komandimi i gjyqtarës Brunilda Orhani si kryetare e Gjykatës së Apelit Korçë.*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË***  
***(Mbajtur, më 11.10.2018)***

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Delegimet.

***Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:18 dhe mbaroi në orën 19:21.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                |                         |
|--------------------------------|-------------------------|
| <b><i>1. Ilir Meta</i></b>     | <b><i>(kryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Gjini Gjoni</i></b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>3. Vangjel Kosta</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>4. Brunilda Kadi</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>5. Eneida Civici</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>6. Petrit Çomo</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b> |
| <b><i>7. Ridvan Hado</i></b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>8. Gerd Hoxha</i></b>    | <b><i>(anëtar)</i></b>  |
| <b><i>9. Neritan Cena</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>  |

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Xhezair Zaganjroi, znj. Etilda Gjonaj, z. Astrit Haxhialushi.*

**Shënim 2:** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018 bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur për subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht anëtar i KLD-sw z. Artan Broci, shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit. Deri në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelit ky gjyqtar, pezullohet nga ushtrimi i detyrës, parashikuar kjo specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 5. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
- 6. Ekspertë të Misionit EURALIUS.**
- 7. Ekspertë të USAID-it.**

## **RENDI I DITËS:**

2. Delegimet.

**Marsida Xhaferllari:** Janë katër çështje procedurale përpara delegimit.

Çështja e parë dhe çështja e dytë lidhen me dy çështje gjyqësore, respektivisht nga Gjykata e Lezhës dhe Gjykata e Kurbinit dhe Gjykata e Krujës, që kërkojnë delegimin e një gjyqtari specifik për shkak të cilësisë që ka pas si gjyqtar i themelit të çështjes, bëhet fjalë për gjyqtarin Jak Ndoka dhe Marcela Shehu. Kjo është një procedurë që është vendosur edhe më përpara nga KLD-ja, por gjithsesi ka nevojë për një miratim formal

nga ana juaj. Çështja e tretë lidhet me Gjykatën e Apelit Durrës e cila vijon dhe parashtron kërkesë që gjyqtarët e kësaj gjykate të mos përfshihen në delegim për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve të ndodhur për shkak të pezullimit të tre gjyqtarëve në këtë gjykatë. Dhe çështja e katërt është një çështje që ngrihet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor...

***Ilir Meta:*** Çështja e tretë.

***Marsida Xhaferllari:*** Dy ishin për Kurbin dhe për Krujën.

Dhe çështja e katërt është që ka të bëjë me dy gjykata, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhet me çështjen që e ka ngritur edhe anëtari i KLD-së, Gerd Hoxha për çështjet ku palë ndërgjyqëse janë gjyqtarët, pra se si do të procedojë KLD-ja në këto raste, do të pranohet kërkesat për delegim apo do të vazhdojnë gjyqtarët e asaj gjykate. Ne ju kemi shpërndarë edhe një material për këtë.

Ne propozojmë që të pranohet kërkesa e kryetarit të gjykatës për gjyqtarin Jak Ndoka.

***Ilir Meta:*** Dakord jemi?

*(Anëtarët janë dakord.)*

***Marsida Xhaferllari:*** Edhe çështja e dytë është e njëjta situatë. Bëhet fjalë për gjyqtaren Marcela Shehu që kërkohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë për të njëjtin shkak.

***Ilir Meta:*** Dakord.

*(Anëtarët janë dakord.)*

***Marsida Xhaferllari:*** Çështja e tretë me kërkesën për të përjashtuar nga delegimet gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

*(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga 13 që ka organikën, sot që flasim funksionon me 7 gjyqtarë dhe ka një lloj... gati përgjysmë. Korça nga 6, shkoi në 4 tani, sot që flasim.

Duhet marrë një lloj vendimi.

Doni ta hiqni për këtë mbledhje?

Dakord. Ju e dini.

**Ilir Meta:** Dakord.

**Marsida Xhaferllari:** Atëherë, përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës nga procesi i delegimit për mbledhjen e sotme.

Çështja e fundit është çështja që...

**Ilir Meta:** Dakord për këtë të tretën me këtë sqarim? E katërta...

(Anëtarët janë dakord.)

**Marsida Xhaferllari:** Elbasani dhe Tirana. Janë dy kërkesa më vete por është e njëjta situatë. Meqenëse me ndryshimet e reja ligjore po shtohet numri i çështjeve gjyqësore ku palë ndërgjyqëse janë gjyqtarët, se qytetarët që janë të pakënaqur nga zvarritjet në gjykim, kanë të drejtën e shpërblimit të dëmit dhe padisin gjyqtarët.

Në këtë situatë, po ndiqet nga kryetarët respektiv edhe nën ndikimin e gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën aty, që të bëhen delegime nga gjykatat e tjera. Na u la neve detyrë që ta analizojmë si situatë. Ne kemi paraqitur një material që ka qarkulluar tek anëtarët e KLD-së. Situata është delikate sepse numri i gjyqtarëve sa vjen edhe ulet. Ka trend ulës. Dhe kjo do krijojë vështirësinë e vetë. KLD-ja deri më sot ka mbajtur qëndrimin që ka deleguar gjyqtarë nga gjykatat e tjera në situata të tilla të procedurës civile. Në qoftë se do ndryshohet praktika e KLD-së, në situatën aktuale ku jemi, ne kemi rekomanduar që vendimi duhet të jetë shumë mirë i arsyetuar për ta lidhur me parimin e sigurisë juridike, për të treguar që cila është situata që po ndryshojmë standardin që po ndjek KLD-ja. Ky ka qenë merakun ynë kryesor. Avantazhe dhe disavantazhe ka tek të dyja mënyrat.

**Brunilda Kadi:** Nga ana e Kryeinspektore është dërguar një përgjigje kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku është orientuar që të pyeten gjyqtarët se çfarë alternativash ofrojnë dhe nga ana e kryetares është bërë mbledhje me gjyqtarët dhe pothuajse – jo pothuajse – por të gjithë ishin të mendimit që duhet të përjashtohen, pra duhet të delegohen gjyqtarë nga rrethet e tjera sepse edhe pse Gjykata e Tiranës është gjykatë e madhe, përsëri, opinionin e palës... është shumë i rëndësishëm jo vetëm të jetë por edhe të duket drejtësia e paanshme, për të mos krijuar këto lloj situatash është më mirë që në fillim, që edhe mos të zvarritet gjykimi, direkt të delegohen. Sepse pala s'mund të ketë besim, sido që të jetë, që ta gjykojë çështjen e kolegut të të njëjtës gjykatë. Kështu që, pak a shumë ky konkluzion ka dalë nga mbledhja.



**Gerd Hoxha:** Meqenëse është kërkesa ime. Një konkluzion i tillë mund të jetë, as që e vë në dyshim fare fjalën... dhomës civile – se Gjykata e Tiranës funksionon me dy dhoma – ne nuk na është përcjellë që ka ndodhur një gjë e tillë në gjykatën civile. E dyta, mendoj që kjo është një zgjidhje që të fshihemi pas gishtit. Në këtë rast kam qenë unë, do të jenë edhe plotë të tjerë. Është zgjidhje që është në kundërshtim me ligjin. Aq më tepër, ne jemi tani në kushte të tilla që na duhet patjetër që të jemi sa më eficientë. Fakti që punoj në Gjykatën e Tiranës nuk do të thotë që duhet të jesh mik me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Tiranës. Mund të ketë ndonjë person aty që mund edhe të mos flas.

**Brunilda Kadi:** Po gjykatat e tjera që kanë nga 5 gjyqtarë?

**Gerd Hoxha:** Edhe gjykatat e tjera. Ligji e ka parashikuar të tillë. Unë them që ne duhet t'i presim rrugën këtij fenomeni se është fenomen shumë i dëmshëm.

Unë jam që ta gjykojë Tirana. Në vickle, absolutisht. Edhe kudo.

**Eneida Civici:** Lidhur me këtë që tha Gerdi, u diskutua edhe herën e kaluar, e ngrita unë në fakt, ka qenë një korrespondencë midis Kryeinspektores dhe kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndoshta edhe të gjykatave të tjera. Ideja është që nuk është vetëm diskutimi që kush do t'i gjykojë paditë që ngrihen ndaj gjyqtarëve. Problemi është që janë bërë kallëzime ndaj të gjithë gjyqtarëve me idenë për t'i hequr nga çështja. Ne kërkuam atëherë një statistikë nga Kryeinspektorja me idenë për të parë që janë shumë? A është fenomen i përhapur apo jo, dhe si do ta adresojmë problemin, sepse është bërë fenomen i përhapur. Kjo u diskutua pak në mbledhje dhe të gjithë gjyqtarët aty kishin mendimin, edhe në rrethe të ngushta por edhe më të gjera, që ndoshta do ishte mirë që t'i përcillej një shkresë edhe Prokurorisë së Përgjithshme, ku t'i kërkohej (nga ana e KLD-së në fakt), ku t'i kërkohej që në rastet kur bëhet një kallëzim penal ndaj një gjyqtari dhe çështja pushohet nga Prokuroria, ndoshta do ishte mirë që ai person të merrej për kallëzim të rremë, se kuptohet që ai kallëzim bëhet vetëm për të hequr gjyqtarin nga çështja.

Lidhur me atë që tha Gerdi, në mbledhje, në dhomën civile të paktën, u mbajt qëndrimi që duhet të delegohen gjyqtarë nga rrethet. Të mos shqyrtohen nga gjyqtarë të njëjtës gjykatë. Ndërkohë u adresua edhe ky problem që shiko se ne po na bëjnë kallëzime vetëm për të na hequr nga dosjet. Se në momentin që të bëjnë kallëzim, ti ke

detyrimin të japësh dorëheqjen, se bëhesh konfliktual me palët. Kështu që kjo është situata. Nuk është vetëm te Gerdi. Në Gjykatën e Tiranës mund të jenë 20 të tilla.

**Petrit Çomo:** Këto janë dy gjëra të ndryshme.

Pjesa e penales është e zgjidhur nga Kodi. Pjesa e dytë është pjesë e Prokurorisë. Tek pjesa civile, që të komandohen gjyqtarë është puna që duhet të ketë një bazueshmëri tek Kodi i Procedurës Civile. Në qoftë se është kjo gjë, në rregull. Në qoftë se nuk është, ne s'mund të dalim sipër Kodit. Pavarësisht se ka pas vendimmarrje – se Gjini atë do të thotë, se s'po i rrihet, se ka pasur një vendimmarrje për Gjinin – puna është që në qoftë se nuk e ka Kodi ne nuk mund ta bëjmë. Ky është mendimi im.

**Gjin Gjoni:** Të them të drejtën, unë nuk jam që të komandohen gjyqtarë nga gjykatat e rretheve, për një arsye shumë të thjeshtë. Do futemi në një qerthull të jashtëzakonshëm dhe gjykatat të cilat kanë pak gjyqtarë, i bie që të vijnë në gjykatat e kryeqytetit sepse gjykatat e kryeqytetit kanë numrin më të madh të tyre dhe do e fusim komplet sistemin në një qerthull, i cili do vijë dhe do gjykojë çështjet. Kështu që për mua është në këtë lloj... dhe ke të drejtë Bruna, që sot drejtësia po shkon akoma më keq. Ka qenë keq dhe po shkon akoma më keq. Problemi është që sa të mundemi ne të eliminojmë të paktën këto burokracitë e tepërta. Për mua nuk është normale, atë që tha edhe Gerdi, ke gjyqtarë në gjykata që nuk flasin me gjysmën për shembull. Dhe nuk është e thënë për shkak të afrimitetit. Kështu që mua s'më duket normale që të marrësh një gjyqtar nga Durrësi dhe ta sjellësh... se mund të ketë 30 çështje Gjykata e Tiranës dhe i bie që komplet Gjykata e Durrësit, Gjykata e Elbasanit, të prishin funksionimin e tyre. Pak që numri, atë që thamë, po bie, dhe në rastin konkret, Kodi nuk e ndalon.

**Gerd Hoxha:** Stimulon paligjshmërinë dhe tregohesh frikacak.

**Gjin Gjoni:** Kështu që le të tregohen dinjitozë gjyqtarët karshi njëri-tjetrit dhe le të gjykojnë aty.

**Neritan Cena:** Zoti President, duhet të mbajmë një qëndrim, në kuptimin e pjesës parimore. Nuk mund të themi tani që nëse do jenë gjyqtarë të rretheve ndërgjyqës ne do komandojmë gjyqtarë nga gjykatat e tjera dhe kur të jetë Gjykata e Tiranës, do ia lejmë vetë Gjykatës së Tiranës. Ose do ta zgjidhim, do themi që do gjykojnë për shkak të emergjencës së krijuar për shkak... Por së pari ne duhet të marrim në analizë se sa i

përhapur është ky fenomen, e para. E dyta, me sa më rezulton mua, janë vetëm disa persona, janë dy-tre avokatë që e bëjnë për një qëllim të caktuar.

**Ilir Meta:** Më fal, cili është mendimi juaj?

**Marsida Xhaferllari:** Neve... Unë mendoj... Bashkohem me mendimin e zotit Çomo, që ligj vet e ka bërë diferencën. Kodi i Procedurës Civile nuk e parashikon si rast, boll faktin që ti e ushtron detyrën, një gjyqtar e ushtron detyrën në të njëjtën gjykatë, në procedurën civile. Që do të thotë, sipas mendimit tim, nuk përbën shkak që të përjashtohet dhe të nisi procedura e delegimit. Në penale, qoftë edhe për shkak të rëndësisë që ka çështja, që bëhet fjalë që rrezikohet edhe liria e lëvizjes së personit, etj., me radhë, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm dhe thotë ‘hiq nga ajo gjykatë çështjen, të vijë një gjyqtar tjetër’. Sa i takon statistikës, ne e morëm këtë statistikë dhe ditën e djeshme, kryetarja e Gjykatës së Tiranës na raporton që sot janë të regjistruara vetëm 5 çështje të tilla. Por ky numër është i sotshmi. Sepse është numër dinamik, në lëvizje. Mbaron një çështje, regjistrohet tjetra.

**Ilir Meta:** T’i qëndrojmë Kodit?

*(Anëtarët janë dakord.)*

**Marsida Xhaferllari:** Është edhe një relacion tjetër shtesë që është përgatitur përpara lejes. Në Gjykatën e Apelit Durrës, në datën 31.07.2018 ka kërkuar delegimin e një çështje penale lirim me kusht tek e cila ka marrë pjesë gjyqtari Ervin Metalla, i cili është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe aktualisht është i pezulluar për shkak ligji. Kërkon delegimin.

Ka qenë çështje me delegim. Ervin Metalla ka qenë në Apel Durrës i deleguar dhe kërkojnë delegim se s’ka kush tjetër ...

Çështja e dytë lidhet me një kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Përmetit i cili kërkon anulimin e dy kërkesave të veta për delegim, pasi gjyqtarja Yrfete Shkreli, që mungonte në detyrë për shkak të lejes së lindjes, është kthyer dhe ajo mund t’i marri këto çështje. Bëhet fjalë për dy çështje gjyqësore. Tre çështje, më falni.

Çështja e tretë lidhet me një rast të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Luljeta Kole, që kërkohet për një çështje që lidhet me ‘kthim i sendit të sekuestruar’, pra e lidhur me themelin dhe kërkohet e njëjta gjyqtare që të delegohet (siç u procedua në dy rastet e

para). Nuk e bëjnë dot gjyqtarët e asaj gjykate. Gjyqtarët e asaj gjykate nuk e bëjnë dot dhe ata orientojnë KLD-në dhe thonë ‘mos bëj shot midis gjithë gjyqtarëve’, meqenëse është një kërkesë në fazën e ekzekutimit që lidhet me themelin e çështjes, e mira është të vijë i njëjti gjyqtar që ka gjykuar themelin. Pra bëhet fjalë për shembull, në rastin konkret, kthim i sendit të sekuestruar.

Çështja e katërt është që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur dy kërkesa për të njëjtën çështje por kjo çështje bie tashmë sepse është paditës gjyqtari Ervin Pollozhani.

Çështja e pestë është Gjykata e Apelit Gjirokastër kërkon për lëshim urdhri ekzekutimi të një vendimi penal, gjyqtarët Nertina Kosova dhe Nure Dreni që kanë gjykuar edhe çështjen e themelit. Kaq janë.

Mirë atëherë, tani vazhdojmë me procedurën e delegimit.

Për çështjen 1, nga Gjykata e Apelit Korçë për në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, midis 3 gjyqtarëve. Kërkohen 2 gjyqtarë. Nga apeli Korçë në apelin Gjirokastër, 2 gjyqtarë. Midis Brunilda Orhanit, Xhavellës dhe Temos.

*Neritan Cena:* Etleva Temo dhe Olsi Xhavella.

*Marsida Xhaferllari:* Etleva Temo dhe Olsi Xhavella.

Hedhim shortin mes gjykatave, apel Korçë, apel Vlorë, Krimet e Rënda për të shkuar në Gjirokastër.

*Neritan Cena:* Krimet e Rënda.

*Marsida Xhaferllari:* Krimet e Rënda.

Apeli i Krimeve të Rënda, 3 gjyqtarë për çështjen nr. 2.

*Neritan Cena:* Guri Brahimllari, Saida Dollani, Idriz Mulkurti.

*Marsida Xhaferllari:* Guri Brahimllari, Saida Dollani, Idriz Mulkurti.

Për çështjen nr. 3, tek e njëjta gjykatë vijojmë. 1 gjyqtar.

*Neritan Cena:* Idriz Mulkurti.

*Marsida Xhaferllari:* Idriz Mulkurti.

Çështja nr. 4, vijojmë po aty se kërkohet prapë në apel Gjirokastër, nga Apeli i Krimeve të Rënda kërkohen 3 gjyqtarë. Për çështjen nr. 4.

*Neritan Cena:* Nure Dreni, Guri Brahimllari, Saida Dollani.

**Marsida Xhaferllari:** Nure Dreni, Guri Brahimllari, Saida Dollani.  
Për çështjen nr. 5, po aty 3 gjyqtarë për të shkuar në apel Gjirokastrë.

**Neritan Cena:** Nertina Kosova, Sokol Binaj, Dhurata Haveri.  
**Marsida Xhaferllari:** Nertina Kosova, Sokol Binaj, Dhurata Haveri.  
Shorti midis apelit Vlorë dhe apelit të Krimeve të Rënda, për të shkuar në apel Gjirokastrë. (Çështja nr. 6.)

**Neritan Cena:** Apeli Vlorë.  
**Marsida Xhaferllari:** Apeli Vlorë. Kërkohen 3 gjyqtarë.  
**Neritan Cena:** Sokol Ngresi, Iliba Bezati, Klodiana Gjyzari.  
**Marsida Xhaferllari:** Sokol Ngresi, Iliba Bezati, Klodiana Gjyzari.  
Kthehu tek Krimet e Rënda sepse është i njëjti kombinacion midis Korçës, Vlorës dhe Krimeve të Rënda për të shkuar në Gjirokastrë. 1 gjyqtar për çështjen nr. 7.

**Neritan Cena:** Gjovalin Përnoca.  
**Marsida Xhaferllari:** Gjovalin Përnoca.  
Për çështjen nr. 8, po aty, 2 gjyqtarë.  
**Neritan Cena:** Dhimitër Lara, Saida Dollani.  
**Marsida Xhaferllari:** Dhimitër Lara, Saida Dollani.  
Vijojmë po aty, 2 gjyqtarë, për çështjen nr. 9.  
**Neritan Cena:** Guri Brahimllari, Albana Boksi.  
**Marsida Xhaferllari:** Brahimllari dhe Albana Boksi.  
Për të shkuar në apelin Korçë, shorti midis apeli Vlorë dhe apelit të Krimeve të Rënda.

**Neritan Cena:** Vlorë.  
**Marsida Xhaferllari:** Apeli Vlorë. 3 gjyqtarë. (Çështja nr. 10.)  
**Neritan Cena:** Brikena Lubonja, Klodiana Gjyzari, Sokol Ngresi.  
**Marsida Xhaferllari:** Brikena Lubonja, Klodiana Gjyzari, Sokol Ngresi.  
Bëj shortin mes gjykatave për të shkuar në apel Korçë. Apeli Gjirokastrë, apel Vlorë, apel Durrës, apel Krimet e Rënda. Durrësi u përjashtua me vendim KLD-je.  
**Neritan Cena:** Apeli Vlorë.  
**Marsida Xhaferllari:** Apeli Vlorë, 3 gjyqtarë për çështjen 11.

*Neritan Cena:* Skënder Damini, Margarita Buhali, Brikena Lubonja.  
*Marsida Xhaferllari:* Skënder Damini, Margarita Buhali, Lubonja.  
Tek çështja 12, vijojmë po aty, 2 gjyqtarë.  
*Neritan Cena:* Brikena Lubonja, Petrit Aliaj.  
*Marsida Xhaferllari:* Lubonja, Aliaj.  
13-ta, po aty, 1 gjyqtar por jo Saliko, jo Lubonja, jo Troka, se kanë pengesë.  
*Neritan Cena:* Petrit Aliaj.  
*Marsida Xhaferllari:* Petrit Aliaj.  
Tek 14-ta, po aty, 1 gjyqtar.  
*Neritan Cena:* Skënder Damini.  
*Marsida Xhaferllari:* Skënder Damini.  
Tek 15-ta, po aty, 3 gjyqtarë.  
*Neritan Cena:* Nazmi Troka, Skënder Damini, Sokol Ngresi.  
*Marsida Xhaferllari:* Nazmi Troka, Skënder Damini, Sokol Ngresi.  
Tek 16-ta, po aty, 1 gjyqtar.  
*Neritan Cena:* Brikena Lubonja.  
*Marsida Xhaferllari:* Lubonja.  
Tek 17-ta, hedhim shortin mes gjykatave: apel Durrës, apel Vlorë, apel Tiranë, apel Krimet e Rënda për të shkuar në Shkodër. Durrësi përjashtohet.  
*Neritan Cena:* Vlorë.  
*Marsida Xhaferllari:* Vlorë. 3 gjyqtarë për të shkuar në Shkodër.  
*Neritan Cena:* Petrit Aliaj, Nazmi Troka, Iliba Bezati.  
*Marsida Xhaferllari:* Petrit Aliaj, Nazmi Troka, Iliba Bezati.  
Tek 18-ta, po aty, 1 gjyqtar.  
*Neritan Cena:* Sokol Ngresi.  
*Marsida Xhaferllari:* Sokol Ngresi.  
Tek 19-ta, po aty, 2 gjyqtarë.  
*Neritan Cena:* Skënder Damini, Klodiana Gjyzari.  
*Marsida Xhaferllari:* Skënder Damini, Klodiana Gjyzari.

Për të shkuar në apel Vlorë. Kujt i ra se e bëmë një herë shortin për të shkuar në Vlorë. E bëmë një herë shortin e apelit Vlorë. Për të shkuar në Vlorë short mes gjykatave: apel Korçë, apel Shkodër, apel Durrës, apel Krimet e Rënda. Durrësi përjashtohet.

*Neritan Cena:* Shkodër.

*Marsida Xhaferllari:* 2 gjyqtarë.

*Neritan Cena:* Selim Kryeziu, Hajrie Muçmata.

*Marsida Xhaferllari:* Selim Kryeziu, Hajrie Muçmata.

Tek 21-shi, po aty, 2 gjyqtarë.

*Neritan Cena:* Luan Dervishi, Valbona Vata.

*Marsida Xhaferllari:* Luan Dervishi, Valbona Vata.

Rrethi Gjyqësor Mat për të shkuar në Rrethin Gjyqësor Dibër. Midis Ali Kolecit dhe Murat Lleshit, 1 gjyqtar.

*Neritan Cena:* Ali Koleci.

*Marsida Xhaferllari:* Ali Koleci.

Tek 23-shi, nga Rrethi Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile) në Rrethin Gjyqësor Elbasan, 1 gjyqtar.

Mos janë këto që u përjashtuan?

Një minutë. Çështja nr. 23 del nga shorti për shkak të vendimit të KLD-së që, u mor që kur janë çështje me palë ndërgjyqëse gjyqtarë civile, nuk delegohen gjyqtarë.

Tek 24-a, nga Rrethi Gjyqësor Kurbin në Rrethin Gjyqësor Krujë, 1 gjyqtar midis Ded Mirit, Marcela Shehut dhe Aurel Arapi.

*(Përzgjidhet Marcela Shehu.)*

Marcela Shehu.

Për 25-ën, po aty, 1 gjyqtar midis të treve.

*Neritan Cena:* Ded Miri.

*Marsida Xhaferllari:* Ded Miri.

Po aty, 1 gjyqtar për 26-ën.

*(Përzgjidhet Marcela Shehu.)*

Marcela Shehu.

Po aty, 1 gjyqtar për 27-ën.

**Gerd Hoxha:** Aureli.

**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi.

Po aty, 1 gjyqtar për 28-ën.

**Gerd Hoxha:** Aurel Arapi.

**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi.

2 gjyqtarë po aty për 29-ën.

**Gerd Hoxha:** Aurel, Ded.

**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi, Ded Miri.

Për 30-ën Marcela Shehu siç u vendos nga KLD-ja sipas çështjes paraprake.

Për 31-shi, Jak Ndoka siç u vendos nga KLD-ja tek çështjet paraprake.

Tek 32-shi, nga Lezha në Kurbin 2 gjyqtarë midis Përdedës, Ndokës dhe Ullirit.

**Gerd Hoxha:** Jak Ndoka, Elsa Ulliri.

**Marsida Xhaferllari:** Jak Ndoka, Elsa Ulliri.

Nga Rrethi Gjyqësor Shkodër në Lezhë, nga Dhoma Penale e Shkodrës në Lezhë,  
3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Tonin Stërkaj, Besmir Stroka, Sokol Shehu.

**Marsida Xhaferllari:** Tonin Stërkaj, Besmir Stroka, Sokol Shehu.

Nga Lezha në Mat, 3 gjyqtarë. Por jo Ded Miri, jo Marcela Shehu. Për 34-ën.

**Gerd Hoxha:** Elsa, Ilir, Artan.

**Marsida Xhaferllari:** Elsa Ulliri, Artan Hajredinaj, Ilir Përdeda.

35-sa nga Kurbin në Mat, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Aureli.

**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi.

1 gjyqtar tek 36-ta, po aty.

**Gerd Hoxha:** Marcela.

**Marsida Xhaferllari:** Marcela Shehu.

Nga Kruja në Tiranë, 1 gjyqtar midis Enkeleda Hoxhës, Engjellushe Tahirit.

Jo, jo. Përrjashtohet kjo sepse është çështje e Rezarta Mataj. E ke tek çështjet paraprake. Përrjashtohet në bazë të vendimit të KLD-së, që kur janë palë ndërgjyqëse gjyqtarët çështjet civile, shorti bëhet në Gjykatën e Tiranës. (Çështja nr. 37.)



Edhe 38-ta, për të njëjtën arsye është Ervin Pollozhani palë ndërgjyqëse. Pra përjashtohet.

39-ta, nga Kukësi në Tropojë, 1 gjyqtar mes Alma Ahmetit, Erjon Çelës, Rexhep Karait.

**Gerd Hoxha:** Rexhep Karaj.

**Marsida Xhaferllari:** 40-ta, nga Kukësi në Tropojë.

**Gerd Hoxha:** Alma Zhupa.

**Marsida Xhaferllari:** Alma Ahmeti.

41-shi anulohet sipas vendimit që mori KLD-ja në çështjet paraprake.

42-shi, nga Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë në Sarandë, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Pëllumb Vehbiu.

**Marsida Xhaferllari:** Jo, jo. Edhe kjo përjashtohet sepse është Ketra Bajrami. Përjashtohet se është çështje civile me gjyqtar.

44, nga Gjirokastra, Administrative Gjirokastrë, 1 gjyqtar mes Blerta Çibukut, Vehbiut, Iliopullit.

**Gerd Hoxha:** Pëllumb Vehbiu.

**Marsida Xhaferllari:** Pëllumb Vehbiu.

43-shi, nuk e bëmë, na shkau. Nga Fieri, në Vlorë. 1 gjyqtar nga Dhoma Civile. Midis Konomit, Dukës, Selmanit, Lazellari, Banushi. 1 gjyqtar për të shkuar në Vlorë.

**Gerd Hoxha:** Konomi.

**Marsida Xhaferllari:** Alfred Konomi.

45-sa, nga Gjirokastra në Administrative Gjirokastrë, 1 gjyqtar. Mes Çibukut, Vehbiut, Iliopullit.

**Gerd Hoxha:** Iliopulli.

**Marsida Xhaferllari:** Iliopulli.

1 gjyqtar tek 46-ta, po aty.

**Gerd Hoxha:** Iliopulli.

**Marsida Xhaferllari:** Iliopulli.

47-ta, 2 gjyqtarë, midis Pëllumb Vehbiut, Mirela Iliopullit, Ketra Bajramit, Nevrie Duka, Enkeleda Doda.

**Gerd Hoxha:** Pëllumb, Ketra.

**Marsida Xhaferllari:** Pëllumb Vehbi, Ketra Bajrami.

Kalojmë tek relacioni nr. 2.

Shorti mes gjykatave, apel Shkodër, apel Tiranë, Korçë, Krimet e Rënda.

**Gerd Hoxha:** Apel Krimet e Rënda.

**Marsida Xhaferllari:** Apeli i Krimeve të Rënda.

Tre gjyqtarë. Jo Nure Dreni.

**Gerd Hoxha:** Saida, Gjovalin, Nertina Kosova.

**Marsida Xhaferllari:** Saida Dollani, Gjovalin Përnoca, Nertina Kosova.

Tek çështja nr. 2, po aty 2 gjyqtarë, por Përnoca, Dreni, Mulkurti kanë pengesë.

**Gerd Hoxha:** Saida, Albana.

**Marsida Xhaferllari:** Saida Dollani, Albana Boksi.

Po aty, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Idriz Mulkurti.

**Marsida Xhaferllari:** Idriz Mulkurti.

Po aty, për çështjen nr. 4, 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Dhurata, Nure, Idriz Mulkurti.

**Marsida Xhaferllari:** Nure Dreni, Dhurata Haveri, Idriz Mulkurti.

Po aty, 3 gjyqtarë për 5-ën.

**Gerd Hoxha:** Gjovalin Përnoca, Gurali Brahimllari, Nertina Kosova.

**Marsida Xhaferllari:** Gjovalin Përnoca, Gurali Brahimllari, Nertina Kosova.

Po aty, 1 gjyqtar, por jo Gjovalin Përnoca, për 6-ën.

**Gerd Hoxha:** Nure Dreni.

**Marsida Xhaferllari:** Nure Dreni.

Për të shkuar në apel Korçë shorti midis Durrësit, Vlorës, Krimet e Rënda.

Durrësi përjashtohet.

**Gerd Hoxha:** Vlorë.

**Marsida Xhaferllari:** Nga Vlora, 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Sokol Ngresi, Iliba Bezati, Nazmi Troka.

**Marsida Xhaferllari:** Sokol Ngresi, Iliba Bezati, Nazmi Troka.

Për çështjen 8, po aty 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Brikena, Klodiana, Skënder Damini.

**Marsida Xhaferllari:** Brikena Lubonja, Klodiana Gjyzari, Skender Damini.

Për 9-ën, po aty 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Iliba Bezati, Klodiana Gjyzari, Sokol Ngresi.

**Marsida Xhaferllari:** Iliba Bezati, Klodiana Gjyzari, Sokol Ngresi.

Po aty, për 10-ën, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Skënder Damini.

**Marsida Xhaferllari:** Skënder Damini.

Për 11-ën, po aty, 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Nazmi Troka, Margarita Buhali, Hysen Saliko.

**Marsida Xhaferllari:** Nazmi Troka, Margarita Buhali, Hysen Saliko.

Po aty, 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Klodiana Gjyzari, Brikena Lubonja, Iliba Bezati.

**Marsida Xhaferllari:** Klodiana Gjyzari, Brikena Lubonja, Iliba Bezati.

Për çështjen 13, 2 gjyqtarë, po aty.

**Gerd Hoxha:** Margarita Buhali, Nazmi Troka.

**Marsida Xhaferllari:** Margarita Buhali, Nazmi Troka.

Për 14-ën, tek Krimet e Rënda mes apelit Durrës, Krimet e Rënda, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. Mes gjithë apeleve domethënë. Përjashtoj Durrësin që mori vendim KLD-ja.

**Gerd Hoxha:** Shkodër.

**Marsida Xhaferllari:** 2 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Lindita Hoxha, Marina Rraboshta.

**Marsida Xhaferllari:** Lindita Hoxha, Marina Rraboshta.

Hidh shortin mes gjykatave për të shkuar në apel Gjirokastër: apel Korçë, apel Vlorë, Krimet e Rënda. Për 15-ën.

**Gerd Hoxha:** Apeli Korçë.

**Marsida Xhaferllari:** 3 gjyqtarë nga apeli Korçë.

**Gerd Hoxha:** Brunilda Orhani, Stavri Kallço, Etleva Temo.

**Marsida Xhaferllari:** Brunilda Orhani, Stavri Kallço, Etleva Temo.

Nga apeli i Krimeve të Rënda për të shkuar në apel Gjirokastër, 2 gjyqtarë. Çështja paraprake. Kosova, Dreni shkojnë automatikisht sepse është e lidhur me çështjen e themelit.

17-ta, shorti mes gjykatave: apel Durrës, Vlorë, apel Tiranë, Krimet e Rënda, për të shkuar në Shkodër.

**Gerd Hoxha:** Krimet e Rënda.

**Marsida Xhaferllari:** Krimet e Rënda. Kërkohet 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Gurali Brahimllari.

**Marsida Xhaferllari:** Gurali Brahimllari.

Po aty, 2 gjyqtarë për 18-ën.

**Gerd Hoxha:** Sokol Binaj, Albana Boksi.

**Marsida Xhaferllari:** Sokol Binaj, Albana Boksi.

Po aty, 3 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Saida Dollani, Idriz Mulkurti, Nure Dreni.

**Marsida Xhaferllari:** Dollani, Nure Dreni dhe Idriz Mulkurti.

Tek 20-ta 2 gjyqtarë. Bëj shortin mes gjykatave: apel Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Durrës, Krimet e Rënda, për të shkuar në Vlorë. Durrësi ikën, nga vendimi i KLD-së.

**Gerd Hoxha:** Korçë.

**Marsida Xhaferllari:** 2 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Olsi Xhavella, Stavri Kallço.

**Marsida Xhaferllari:** Olsi Xhavella, Stavri Kallço.

Tek 21-shi, po aty, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Olsi Xhavella.

**Marsida Xhaferllari:** Olsi Xhavella.

Tek 22-shi, po aty, 2 gjyqtarë.

**Gerd Hoxha:** Brunilda Orhani, Etleva Temo.

**Marsida Xhaferllari:** Brunilda Orhani, Etleva Temo.

Tek 23-shi, po aty, 2 gjyqtarë.

***Gerd Hoxha:*** Etleva Temo, Olsi Xhavella.  
***Marsida Xhaferllari:*** Etleva Temo, Olsi Xhavella.  
Tek 24, po aty, 1 gjyqtar.  
***Gerd Hoxha:*** Stavri Kallço.  
***Marsida Xhaferllari:*** Stavri Kallço.  
Tek 25, nga Mati në Dibër 1 gjyqtar mes Ali Kolecit dhe Murat Lleshit.  
***Gerd Hoxha:*** Murat Lleshi.  
***Marsida Xhaferllari:*** Murat Lleshi.  
Po aty, tek 26-ta 1 gjyqtar.  
***Gerd Hoxha:*** Ali Koleci.  
***Marsida Xhaferllari:*** Ali Koleci.  
1 gjyqtar nga Kurbin në Krujë, mes Ded Mirit, Marcela Shehut, Aurel Arapit.  
***Gerd Hoxha:*** Aurel Arapi.  
***Marsida Xhaferllari:*** Aurel Arapi.  
Po aty, 1 gjyqtar për 28-ën.  
***Gerd Hoxha:*** Ded Miri.  
***Marsida Xhaferllari:*** Ded Miri.  
Po aty, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 29.)  
***Gerd Hoxha:*** Marcela Shehu.  
***Marsida Xhaferllari:*** Marcela Shehu.  
2 gjyqtarë po aty, për 30-ën.  
***Gerd Hoxha:*** Ded Miri, Aurel Arapi.  
***Marsida Xhaferllari:*** Ded Miri, Aurel Arapi.  
Nga Dhoma Civile e Tiranës në Krujë, 1 gjyqtar, por jo Anila Kristani, se ka pengesë. (Çështja nr. 31.)  
***Gerd Hoxha:*** Enkela Bajo.  
***Marsida Xhaferllari:*** Enkela Bajo.  
Tek 32-shi, nga Lezha në Kurbin, 1 gjyqtar.  
***Gerd Hoxha:*** Artan Hajredinaj.  
***Marsida Xhaferllari:*** Artan Hajredinaj.

Nga Fieri tek Dhoma Penale në Lushnje, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 33.)  
**Gerd Hoxha:** Adelina Zarka.  
**Marsida Xhaferllari:** Zarka.

Tek 34 nga Kurbini në Lezhë, 1 gjyqtar.  
**Gerd Hoxha:** Ded Miri.  
**Marsida Xhaferllari:** Ded Miri.

Po aty 1 gjyqtar për 35-ën.  
**Gerd Hoxha:** Aurel Plasari (lapsus mbiemri).  
**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi.

Nga Gjirokastra në Përmet, 1 gjyqtar (Çështja nr. 36). Është anuluar, çështja numër 2 paraprake sipas vendimit të KLD-së.  
Edhe çështja 37 është anuluar sipas çështjes paraprake.

Tek 38-ta shkon Luljeta Kole, sipas vendimit që mori KLD-ja tek parapraket.  
Nga Korça në Pogradec për 39-ën, nga Dhoma Civile, 1 gjyqtar.  
**Gerd Hoxha:** Besnik Shehu.  
**Marsida Xhaferllari:** Besnik Shehu.

Nga Shkodra (Dhoma Penale) në Pukë, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 40.)  
**Gerd Hoxha:** Tonin Stërkaj.  
**Marsida Xhaferllari:** Tonin Stërkaj.

Po aty, 1 gjyqtar për 41-shin.  
**Gerd Hoxha:** Luveda Dardha.  
**Marsida Xhaferllari:** Luveda Dardha.

Po aty, 1 gjyqtar për 42-shin.  
**Gerd Hoxha:** Tonin Stërkaj.  
**Marsida Xhaferllari:** Tonin Stërkaj.

Nga Vlora në Sarandë, 2 gjyqtarë për 43-shin. Arqile Basho dhe Laurent Fuçia kane pengese.  
**Gerd Hoxha:** Herila Çela, Ervin Trashi.  
**Marsida Xhaferllari:** Herila Çela, Ervin Trashi.

Nga Kruja, midis Enkeleda Hoxhës, Engjellushe Tahirit, 1 gjyqtar për të shkuar në Tiranë.

**Gerd Hoxha:** Engjellushe Tahiri.

**Marsida Xhaferllari:** Engjellushe Tahiri.

45, nga Kukësi në Tropojë, 1 gjyqtar.

**Gerd Hoxha:** Rexhep Karaj.

**Marsida Xhaferllari:** Rexhep Karaj.

Po aty, 1 gjyqtar për 46-ën.

**Gerd Hoxha:** Erjon Çela.

**Marsida Xhaferllari:** Erjon Çela.

Po aty, 1 gjyqtar për 47-ën.

**Gerd Hoxha:** Alma Ahmeti.

**Marsida Xhaferllari:** Alma Ahmeti.

Po aty, 1 gjyqtar për 48-ën.

**Gerd Hoxha:** Rexhep Karaj.

**Marsida Xhaferllari:** Rexhep Karaj.

Për 49-ën, nga Korça në Administrative Korçë, 1 gjyqtar mes gjyqtarëve me 5 vjet përvojë.

**Gerd Hoxha:** Ariola Kristo.

**Marsida Xhaferllari:** Ariola Kristo.

Po aty, 1 gjyqtar për 50-ën.

**Gerd Hoxha:** Seladin Pysqyli.

**Marsida Xhaferllari:** Seladin Pysqyli.

Po aty, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 51.)

**Gerd Hoxha:** Besnik Shehu.

**Marsida Xhaferllari:** Besnik Shehu.

Për 52-shin, nga Gjirokastra, shkalla e parë Administrative Gjirokastër, 1 gjyqtar.

(Përzgjidhet Blerta Çibuku.)

Blerta Çibuku.

Nga Gjirokastra në Administrative Gjirokastër, po aty 1 gjyqtar.

**Gjin Gjoni:** Mirela Iliopulli.

**Marsida Xhaferllari:** Mirela Iliopulli.

Tek 54, po aty 1 gjyqtar.

**Gjin Gjoni:** Mirela Iliopulli.

**Marsida Xhaferllari:** Po aty, 1 gjyqtar për 55-ën.

**Gjin Gjoni:** Blerta Çibuku.

**Marsida Xhaferllari:** Blerta Çibuku.

Tre çështjet e fundit që janë në relacion më vete.

Për 1-shin shorti mes gjykatave: apel Korçë, Vlorë, Krimet e Rënda.

(Përzgjidhet gjykata Krimet e Rënda.)

Krimet e Rënda, 1 gjyqtar.

**Gjin Gjoni:** Gurali Brahimllari.

**Marsida Xhaferllari:** Gurali Brahimllari.

Për 2-shin nga Kurbinë në Lezhë, mes Ded Mirit, Marcela Shehut, Aurel Arapit.

**Petrit Çomo:** Aurel.

**Marsida Xhaferllari:** Aurel Arapi.

Dhe e fundit. Nga Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë në Administrative Gjirokastrë, 1 gjyqtar tek gjyqtarët me 5 vjet vjetërsi.

**Petrit Çomo:** Pëllumb Vehbiu.

**Marsida Xhaferllari:** Pëllumb Vehbi.

Mbaruam.

**Ilir Meta:** Po, Neritani, po!

**Neritan Cena:** Kur komandua pjesën e kryetares së apelit (*zoti Cena i rikthehet pikës së parë të rendit të ditës*), parimisht vendimi i kryetares së mëparshëm konsiderohet ‘e pezulluar’ dhe vetvetiu (se nuk mund të paragjykojmë vendimmarrjet e instancave më të larta), Komisioni i Apelit mund ta rikthejë në detyrë, por mund të ndodhë edhe pjesa tjetër, që mund të konfirmohet vendimi i shkarkimit dhe do detyrohemi më pas të rimblidhemi që të komandojmë ose të njëjtën gjyqtare ose mund të komandojmë dikë tjetër. Tani, a mund ta shtojmë një fjali që nëse konfirmohet vendimi i shkarkimit ‘të



vijojë komandimin’, sepse mund të jemi në një situatë që mund të mos mblidhemi më. Kjo është ideja.

*Ilir Meta:* Ne do mblidhemi.

Siç kemi rënë dakord: ‘Vendosi: Të komandojë gjyqtaren Brunilda Orhani për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të Gjykatës së Apelit Korçë’. Kuptohet që, nëse e fiton të drejtën, rikthehet dhe ky komandim bie. Kështu që...

Me delegimet dakord jemi?

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË***  
***(Mbajtur, më 11.10.2018)***

***Pika 3 shtesë e rendit të ditës me objekt:*** Mbi kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, zotit Gjin Gjoni, për “Leje prindërore”.

***Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 18:18 dhe mbaroi në orën 19:21.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                |                          |
|--------------------------------|--------------------------|
| <b><i>1. Ilir Meta</i></b>     | <b><i>(kryetar)</i></b>  |
| <b><i>2. Gjin Gjoni</i></b>    | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b><i>3. Vangjel Kosta</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b><i>4. Brunilda Kadi</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b>  |
| <b><i>5. Eneida Civici</i></b> | <b><i>(anëtare)*</i></b> |
| <b><i>6. Petrit Çomo</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>  |
| <b><i>7. Ridvan Hado</i></b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b><i>8. Gerd Hoxha</i></b>    | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b><i>9. Neritan Cena</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>   |

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Xhezair Zaganjroi, znj. Etilda Gjonaj, z. Astrit Haxhialushi.**

**Shënim 2:** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018 bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur për subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht anëtar i KLD-sw z. Artan Broci, shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit. Deri në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelit ky gjyqtar, pezullohet nga ushtrimi i detyrës, parashikuar kjo specifikisht në nenin 62 të ligjit nr. 84/2016.

**Shënim 3:** Zonja Civici largohet për një moment nga salla e mbledhjes për t’u rifutur sërish nga fundi i kësaj pike.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
2. **Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
4. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
5. **Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
6. **Ekspertë të Misionit EURALIUS.**
7. **Ekspertë të USAID-it.**

#### **RENDI I DITËS:**

3 (Shtesë). Mbi kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, zotit Gjini Gjoni, për “Leje prindërore”.

**Ilir Meta:** Po, çfarë çështje kishit Gerdi?

**Gerd Hoxha:** Është edhe një kërkesë zoti Kryetar që ka ardhur me protokoll, kërkesë e njërit prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zotit Gjoni i cili kërkon

t'i akordohet një leje për periudhë 2-vjeçare "Leje prindërore", në bazë të ligjit 96/2016, neni 24, parashikohet "Leja prindërore". Në kërkesën e tij zotëria parashtron faktin se është bërë me vajzë. Vajza ka shtetësi gjermane. Së bashku me bashkëshorten janë rezidente në Gjermani dhe qëndrimi jashtë këtij vendi jo të Bashkimit Evropian (d.m.th. Shqipëri) më shumë se tre muaj nuk lejohet, kështu të gjitha vizitat dhe kontrollet periodike do të bëhen në shtetin gjerman për një periudhë 2-vjeçare çka janë të shpeshta dhe do kërkojnë angazhimin, shkëputjen time të herëpashershme, -thotë zoti Gjoni, -nga puna, e do të krijonte probleme në vazhdimësinë e gjykimeve e zvarritjen e dosjeve që ka në proces. Për këtë arsye, është në nderin e tij që ne t'i japim leje.

**Ilir Meta:** Po! Dakord, atëherë!

Japim leje për...

Mirë, atëherë, faleminderit!

**Gerd Hoxha:** Mesa lexova dhe mesa rela... mendoj se kërkesa është e bazuar në ligj dhe të pranohet sipas kërkesës.

**Ilir Meta:** Po! Kush është dakord?

Po! Jemi dakord!

Mirë, atëherë! Të të rrojë vajza dhe tjetër herë me djalë.

E mbyllim atëherë?

**Neritan Ceta:** Eneida, ku vajti?

**Ilir Meta:** Bëji një telefon po qe se ashtu...

*(Rihyn në sallë zonja Civici.)*

**Gerd Hoxha:** Atëherë, zoti President, kuorumi është.

**Ilir Meta:** Atëherë, ju lutem, meqenëse u ribë kuorumi, zoti Gerdi ju lutem, çështja që kishit ju.

**Gerd Hoxha:** Edhe një herë parashtror kërkesën që ka paraqitur zoti Gjoni për t'i akorduar në bazë të ligjit 96/2016, neni 24 "Leje prindërore" dyvjeçare, për shkak se në datën 16 gusht është shtuar, është bërë baba me një vajzë, e cila ka nënshtetësi gjermane. Për arsye...

*(Një nga anëtarët ndërhyjnë duke i thënë zotit Hoxha që e ka lexuar një herë kërkesën.)*

Meqenëse erdhi Eneida dhe zoti President më tha.

Për këtë arsye kërkoj që ta kaloj në votim kërkesën e tij për t'i dhënë leje. Unë jam dakord. Vetëm duhet të vendosim datën e fillimit të lejes. Data 1 nëntor.

***Ilir Meta:*** Dakord?

Kush është dakord për lejen?

Dakord!

Miratohet!

***Gerd Hoxha:*** Ju faleminderit!

***Ilir Meta:*** Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 3 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë**